

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

From: blerta.goxha@tirana.al -- Blerta Goxha <blerta.goxha@tirana.al>
Sent: Thursday, July 22, 2021 1:06 PM
To: qendra.respublica@gmail.com
Cc: info@idp.al
Subject: Përgjigje nga Bashkia Tiranë për shkresën me nr. 1193/1 prot., datë 14.07.2021

Follow Up Flag: Follow up
Flag Status: Completed

Përsëritet,

Në vijim të kërkesës suaj ardhur nëpërmjet adresës së koordinatorit për të drejtën e informimit, pranë Bashkisë Tiranë protokolluar përkatësisht me nr. prot. Q-12330, datë 07.06.2021 dhe shkresës së ardhur nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me nr. 1193/1 prot., datë 14.07.2021, protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 28145 prot., datë 15.07.2021 mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare, ju informoj se, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pas shqyrtimit të kërkesës, ka dërguar informacionin përkatës që disponon, të cilin po ju'a vë në dispozicion, si më poshtë:

"Në përgjigje të kërkesës tuaj të sipërcituar, me anë të cilës kërkon informacion nëse lejohen vendosja e ashensorëve në pallatet ekzistues si dhe cilat janë kushtet/kriteret dhe procedurat për vendosjen e tyre, ju bëjmë me dije se:

Me datë 31.07.2014 ka hyrë në fuqi ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Urdhresës së Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 për "Procedurën e shqyrtimit të aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi, deklaratë paraprake për kryerje punimesh, certifikatë përdorimi, genplane azhomimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar),

Në bazë të legjislacionit të sipërcituar, referuar nenit 7 (Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh) të VKM-së 408 (i ndryshuar) përcaktohet se "Pa përjashtuar detyrimin e respektimit të dispozitave ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për veprimtaritë ndërtimore, përfshirë, në mënyrë të veçantë, sa i përket qëndrueshmërisë, mbrojtjes nga zjarri, ruajtjes së sigurisë dhe higjienës shëndetësore, kryhen pa pajisjen me leje ndërtimi, pas njoftimit të deklaratës paraprake të fillimit të punimeve pranë autoritetit kompetent të planifikimit dhe zhvillimit, të gjitha punimet me anë të të cilave bëhet ndryshimi i organizimit të hapësirës në objekt, zëvendësimi i aparaturave dhe pajisjeve ekzistuese, si dhe ndryshimet, të cilat nuk ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit e nuk ndryshojnë elementet konstruktive mbajtëse, përfshirë dhe vendosja e ashensorëve.

Gjithashtu ju njoftojmë se në nenin 8 të VKM-së të sipërcituar është përcaktuar dokumentacioni i detyrueshëm dhe procedura e shqyrtimit të aplikimit për "Deklaratë Paraprake Punimesh".

Gjithashtu ju bëj me dije se përgjigja zyrtare do ju niset dhe nëpërmjet shërbimit postar në adresën e deklaruar nga ana juaj.

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.